



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 607/ 2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga Ferit Osmani kryesues, Vllastimir Dimic dhe Nehat Idrizi anëtarë, përkatësi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) paraqitur kundër kontrolluesit të rreshtit në vendvotimin (VV) Nr. 1512/02 Plemetin, komuna Obiliq, në lidhje me parregullsi gjate procesit zgjedhor, në seancën e mbajtur më 15.12.2010, mori:

### VENDIM

**HIDHET** poshtë si e palejuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV)

### ARSYETIMI

Më datë 13.12.2010 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga LVV paraqitur përkundrejt kontrolluesit të rreshtit VV Nr. 1512/02 Plemetin-Obiliq, në të cilën pretendohet se “në VV e lartcekur me datë 12.12.2010 rreth orës 07:45 minuta tri here është tërhequr vërejtja për mospërdorimin e llamjes ultravjollce. Parashtruesi i ankesës thekson se në këtë rast është bere shkelje e Rregullës Zgjedhore Nr. 09/2009 përkatësisht neni 11”.

Ne mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotokopje të shënimeve të Behar Gashit me numer kodi të identifikimit 15/333, në rolin e vëzhguesit, ku raportohet se në orën 07:45; 07:50; 09:05; 10:25; 11:45 dhe 12:10 detektorët nuk kanë funksionuar. Njëkohësisht parashtruesi i ankesës ka ofruar në rolin e dëshmitarit emrat e Hafiz Rusinovci vëzhgues i PDK-se dhe Driton Paloja vëzhgues i AAK-se (nuk është paraqitur asnjë numër kontakti për të dy vëzhguesit).

Neni 59 paragrafi 2 i LZP-së, specifikon si me poshtë:

*59.2 KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji;*

Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, neni 6.4 (Vendimet për Ankesat) parasheh si vijon:

6.4 "Panelet mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo at të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie".

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

**-ankesa është e palejuar**

PZAP-i vlerëson se ankesa e LVV-se paraqitur përkundrejt kontrolluesit të rreshtit në VV Nr. 1512/02 Plemetin-Obiliq, është jashtë juridiksionit të PZAP, për shkak se KQZ është organi i cili merret me funksionalizimin dhe organizimin e zgjedhjeve duke përfshirë edhe përdorimin e detektorëve gjatë procesit të zgjedhjeve, fakt ky që konfirmohet nëpërmjet Rregullës Zgjedhore Nr. 09/2009. Prandaj për këtë arsye dhe në pajtim të dispozitave ligjore të cekura më lartë si dhe në pajtim të nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 607/2010 më datën 15.12.2010.

